

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E BRENDSHME

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 418 prot

Tiranë, më 13/12/2022.

VENDIM

Nr. 7 datë 12/12/2022

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 12.12.2022

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi në mbledhjen e datës 12.12.2022 vendosi:

1. Për projektligjin "**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"**", propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
  - a) Neni 60/1 ku citohet "përdorimi i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar", duhet specifikuar ... fondet që janë të lejuara të mbarten.
  - b) "Fondet e trashëguara dhe të pa angazhuara, jo më pak se 30 përqind e tyre përdoren për.....", duhet të shtohet një nen tjetër këtu në ligjin 68/2017. Bashkitë duhet të ndajnë jo më se pak 10% të të ardhurave të veta për shlyerje të detyrimeve ligjore në raste se ato ekzistojnë. Ky sugjerim lidhet me faktin që të mos bëhet qëllim më vete mos angazhimi i fondeve.
  - c) Të hiqet pika 2 e ligjit për pagimin e faturave në kohë, të mos jetë për te gjitha bashkitë.
  - d) "Fondet e trashëguara dhe ta paangazhuara" të përdoren "jo më pak se 30 përqind e tyre" për shlyerjen e "detyrimeve të prapambetura" dhe pagimin e nënshuave të papaguara në kohë", nuk është i argumentuar dhe kufizon autonominë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Kufizimi të hiqet nga neni 2, duke lejuar që fondet e trashëguara dhe të

- papërdorura, që janë fonde të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të përdoren plotësisht për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, pagimin e nënshkrimeve të papaguara në kohë apo detyrime të tjera ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore
- e) Ndryshimin në nenin 2 për shtesën e nenit 60/1 “Përdorimi i fondeve të trashëguara nga viti i kaluar”, pika 1 të riformulohet, si vijon:  
Fondet e trashëguara dhe të paangazhuara të përdoren për:  
a) shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.  
b) Pagimin e nënshkrimeve të papaguara në kohë.”
2. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e Informimit”**”, propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
- a) Referuar masës së gjobës, nisur nga fakti se jo në të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, niveli i pagave të nëpunësve publikë është i njëjtë, mund të ketë vend për të bërë një saktësim lidhur me ndryshimet në masat e gjobave në referencë të parimit të proporcionalitetit, nisur nga fakti se jo për të gjitha shkeljet e parashikuara nga ligji, kufiri minimal i masës së gjobës është ulur.
- b) Neni 2, pika 3”Programi i transparencës bëhet publik në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik”, duhet të specifikohet se çfarë nënkuptojnë me “publik”, pasi programi i transparencës ka qenë detyrim të ishte publik për qytetarët dhe me ligjin pa ndryshimet aktuale.
- c) Neni 9/1 i projektligjit të jetë neni 10 dhe neni 10 i ligjit të jetë neni 10/1.
- d) Neni 5, gërma “e”, të hiqet fjala "veçanërisht"
- e) Neni 5, gërma “e” e projektligjit të hiqet “si dhe organizon trajnime për këtë qëllim”. Kjo pasi pika “gj” trajton plotësisht kompetencën e ofrimit të trajnimeve nga ana e Komisionerit.
- f) Neni 11 i projektligjit, pika 1, shkronja “nj” përcaktohet si përgjegjësi e titullarit të autoritetit publik, si dhe pika 4, shkronja “një” përcaktohet si përgjegjësi e çdo personi përgjegjës. Për të mos shkaktuar konfuzion në përcaktimin e përgjegjësisë shkronja ”nj” nuk mund të jetë edhe përgjegjësi e titullarit edhe përgjegjësi e çdo personi përgjegjës. Duhet të specifikohet subjekti i vetëm i përgjegjësisë.
- g) Neni 24/2 “Kërkesat Abuzive”, kërkohet të sqarohet termi i kërkesë abuzive; Pika 16, në kreun III “Argumentimi i projektaktit lidhur me përparësitë, problematikat, efektet e pritshme” në relacion nuk jep një shpjegim konkret. “Barrë për autoritetin publik” kur për të vendosur në dispozicion të kërkuesit informacionin, detyrohet të përdorë në mënyrë joproporcionale dhe joeficiente burimet e tij”. Barra e provës i takon autoritetit publik ndaj duhet një qartësim të asaj që konsiderohet “abuzive”, në pikën 1, të nenit 24/2 të projektaktit.
- h) Neni 2 pika 6, “koordinatori për të drejtën e informimit” të caktohet një nga nëpunësit/punonjësit e rangut të lartë të autoritetit publik. Ky propozim është detajuar në

- pjesën e fundit ku sugjerohet shtimi i një neni 9/1 me titull "Koordinatori për të drejtën e informimit".
- i) Neni 15 pika 5, kufizon aksesin në informacionin. Ligji aktual për arkivat nuk siguron parimisht ndonjë të drejtë të shprehur të aksesit të publikut në arkiva dhe kështu mbetet që këtë të drejtë parimisht ta shprehë ligji nr. 119/ 2014. Nëse problemi që ka shtyrë komisionerin të propozojë këtë ndryshim lidhet me kostot e dhënies së informacionit, ky aspekt mund të rregullohet me tarifa të veçanta, siç rregullohet aktualisht nga ligji. E njëjta problematikë jepet dhe në pikën 7 të nenit 17.
- j) Neni 17 pika 1 krijon një pengesë artificiale dhe të panevojshme që kufizon të drejtën për informim në mënyrë jo proporcionale. Në rast se informacioni kërkohet për një investigim eventual nga një organizatë apo gazetar, vënia në dijeni e mbajtësit të të dhënave, do të krijonte mundësi potenciale që ky i fundit të vepronte/reagonte, qoftë edhe në mënyra të paligjshme, për të penguar investigimin. Nëse kjo dispozitë do të mbetet si më sipër, njoftimi do të afektojë afatin 10 ditor të kthimit të përgjigjes. Draftit i mungojnë afatet se brenda sa ditësh do të duhet të njoftohen mbajtësit e të drejtave dhe brenda sa ditësh ata do të mund të kthejnë përgjigje. Duhet një ndarje të afateve, pa cënuar afatin ligjor (10 ditor), për shembull; afat 2 ditor për njoftimin e mbajtësit të të drejtave, afat 5 ditor për kthimin e përgjigjes nga mbajtësi i të drejtave, afat 3 ditor për trajtimin final të kërkesës për informacion.
- k) Neni 6 i ligjit (Programet e transparencës), pas togfjalëshit "miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës", duhet të shtohet togfjalëshi "të përshtatura/individualizuara për çdo..."
- l) Pas nenit 9 të ligjit të shtohet një nen 9/1 me titull "Koordinatori për të drejtën e informimit", me këtë përmbajtje: 1) Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Autoriteti publik ka detyrimin e njoftimit të menjëhershëm të emërimit apo ndryshimit të koordinatorit për të drejtën e informimit. 2) Nëpunësi i caktuar si koordinator për të drejtën e informimit duhet të përmbushë të paktën kriteret e mëposhtme:
1. Të jetë nëpunës civil i nivelit të lartë/mesëm drejtues ose nëpunës në pozicione të larta në hierarkinë e institucionit.
  2. Të ketë të paktën X vjet eksperiencë pune në institucion.
  3. Të ketë formimin arsimor ligjor, marrëdhënie me publikun ose në fusha të tjera të përshtatshme me këtë detyrë.
  4. Titullari i autoritetit publik, urdhëron menjëherë strukturat e institucionit për të mbështetur dhe bashkëpunuar me koordinatorin për të drejtën e informimit gjatë përmbushjes së detyrës së tij.
- m) Neni 18/2 pas germës "nj" të shtohet germa "0" me këtë përmbajtje: "mos ekzekutimi i vendimeve të komisionerit sipas parashikimeve të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 300 000 lekë" dhe në nenin 19 "përgjegjësia administrative i ngarkohet titullarit" (pika 1).

- n) Neni 24 pika 6 të riformulohet; “Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim në afatin e parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind drejta për t’iu drejtuar gjykatës. Në çdo rast, edhe pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet në ankesën e paraqitur dhe të marrë vendim të arsyetuar”. Ky ndryshim të shoqërohet me shtim të një pike pas pikës a), pika 2 e nenit 9/1 të shtuar si vijon; “Komisioneri është i detyruar të dali me Vendim për cdo ankesë sipas pikës a) të pikës 2 të këtij neni”.
- o) Neni 26 nuk është adekuat për gjykatat. Mungojnë kritere për vlerësimin e dëmit. Të caktohen modalitetet, duke shtuar edhe kritere për masën e shpërblimit të dëmit, të tilla si: cilësia e kërkuesit; rëndësia e informacionit; vonesa; sjellja e insitucionit, etj.
- p) Neni 26 të shtohet edhe një fjali: “Komisioneri për të drejtën e informimit dhe autoriteti publik janë përgjegjës solidarë në masë të barabartë për dëmin e shkaktuar. Komisioneri për të drejtën e informimit ka të drejtë të kërkojë nga gjykata që pjesa e tij e dëmit të jetë më e vogël, kur arrin të provojë se shkalla e tij e fajit është më e vogël, si dhe të shmanget tërësisht nga përgjegjësia, nëse arrin të provojë përpara gjykatës se ka marrë të gjitha masat e parashikuara nga ligji për përmbushjen e kërkesës për informim.”
3. Për projektligjin “**Për mbrojtjen e të dhënave personale**”, propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- a. Në lidhje me sanksionet e propozuara në projektligj, sugjerojmë që në nivelin e tyre të merren në konsideratë të gjitha kategoritë e subjekteve/ autoriteteve publike që mund të jenë në shkelje të detyrimeve të parashikuara në projektligj me qëllim që masa e ndëshkimit të jetë sa më proporcionale.
- b. Bashkitë e varfëra apo bashkitë e vogla, duhen mbështetur në dy drejtime:
1. Për trajnimin e personave që administrojnë, mbrojnë apo përpunojnë të dhënat personale të subjekteve, për shërbimet publike që mbulojnë bashkitë,
  2. Për mbështjetjen dhe përmirësimin e teknologjisë digjitale.
4. Për projektvendimin mbi “**Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve**”, propozuar nga Ministria e Brendshme, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
5. Për projektvendimin “**Për një shtesë në VKM nr. 559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore”**”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:


- a. Në pikën 5 të projektvendimit të saktësohet dhe shtohet një fjali me këtë formulim “Çmimi i shitjes së lëndës drusore në këmbë, lëndës së punimit dhe druve të zjarrit për njësi (m3) për çdo rast të jetë më i madh se tarifat e përcaktuara në shtojcat 3/1 dhe shtojcën 3/2, ndërsa çmimi i shitjes së materialit drusor të asortuar, që shitet në anë të rrugës në ankand të jetë gjithnjë mbi çmimin e kostos së prodhimit”.
  - b. Uljen e tarifave për ngritjen e fidanishteve pyjore (shtojca nr.1, pika 1), për tarifat për agropylltari (shtojca nr., pika 5), për uljen me 50 %, për të nxitur ngritjen e fidanishteve dhe përdorimin e territorit djerr për mbjelljen e pyjeve.
  - c. Në shtojcën “Tarifat për prodhimet drusore dhe jo drusore, për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jo pyjore”, pika 3/1 “Tarifat bazë të lëndës drusorë në këmbë”, sugjerojmë që në tabelën përkatëse të përcaktohet minimumi i trashësisë së lëndës drusore në këmbë që lejohet të pritët, pasi nuk ka kufi minimum i trashësisë së lëndës që lejohet të pritët, duke dëmtuar rëndë lëndën drusore në rritje.
  - d. Në Shtojcën 3, pika 3/2 “Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë, për llojet industriale” të përcaktohet minimumi i trashësisë së lëndës drusore në këmbë për prodhim industrial, duke parandaluar dëmtimin e lëndës drusore të hollë, të pa zhvilluar dhe shkaktuar humbje ekonomike për njësitë e vetëqeverisje vendore.
  - e. Sugjerojmë që në Shtojcën 3, pika 3/2 “Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë, për llojet industriale” të përcaktohet minimumi i trashësisë së lëndës drusore në këmbë për prodhim industrial, duke parandaluar dëmtimin e lëndës drusore të hollë, të pa zhvilluar dhe shkaktuar humbje ekonomike për njësitë e vetëqeverisje vendore.
6. Për projektvendimin **“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve spitalore”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
  7. Për draftin e **“Strategjisë Kombëtare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023-2030”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
  8. Për projektvendimin **“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të akordimit të fondeve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtarive të tjera në fushën e mbrojtjes civile”**, propozuar nga Ministria e Mbrojtjes/Agjencia e Kombëtare e Mbrojtjes Civile, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
    - a) Neni 6. “në rastet e transferimit të fondeve te bashkitë (NJQV)... pika “b” miratimi i kërkesës nga Prefekti...Ky nen duhet të hiqet fare. Kërkesat e kryetarit nuk ka arsye t’i konfirmojë Prefekti.
    - b) Neni 7, pika “d”, “Kërkesë e argumentuar nga prefekti...Për nevojën e ndërhyrjes...” edhe ky nen është pa kuptim dhe duhet të hiqet. Mjaftueshëm dhe besueshëm është bashkia. Nuk ka arsye për te krijuar këtë dualitet.

- c) Neni 10. "...fondet e akorduara NJQV-ve nga AKMC...sipas urdhrat të nxjerrë nga AKMC...,e fjala "urdhër" duhet të zëvendësohet me "sipas marrëveshjes për qëllimin e fondit..."
- d) Neni 11. Prefekti siguron dhe kontrollon zbatimin...
- a. Duhet të hiqet fare pasi prefekti nuk ka pushtetin dhe kapacitetin për kontrolle teknike të zbatimit të projekteve,
  - b. Mund të zëvendësohet me "AKMC monitoron dhe vlerëson përdorimin e fondeve të dhëna NJQV-ve..."
- e) Të rishikohet pika "d" e projektvendimit në lidhje me kërkesën e bashkive sepse prefekti përbën një hallkë shtesë.
9. Për projektvendimin **"Për kushtet, kriteret dhe procedurat e përfitimit, të poseduesve të ndërtimeve pa leje në rastet e fatkeqësive natyrore"**, propozuar nga Kryeministria/ Agjencia Shtetërore e Kadastrës, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim:
10. Për projektvendimin **"Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunim ndërmjet institucioneve"**, propozuar nga Kryeministria/ Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- a) Rregullat e vendosura në këtë projektvendim rëndojnë pozitën financiare të Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duke i ngarkuar atyre një barrë të shtuar financiare lidhur me procedurën e përditësimit dhe regjistrimit më tej të pronave në administrim/ pronësi të Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
  - b) Neni 37 i ligjit 20/2020 parashikon si dokumentacion të detyrueshëm lidhur me këtë proces sipas nenit 37 pika 3 "Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose Njësia e Vetëqeverisjes Vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik. Kërkesat e shtuara lidhur me dokumentacionin që kërkohen përsëri sipas këtij vendimi duhet të nënshtrohen tarifave për shërbimet kadastrale të parashikuara në VKM nr.389/2020.
  - c) Neni 7 i Kreut II, lidhur me tarifën e shërbimit të regjistrimit të pronave, ky nen duhet të shihet i lidhur me nenin 43 të ligjit 20/2020 sipas të cilit; "Për regjistrimin fillestar të pronave të institucioneve shtetërore dhe të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore aplikohen tarifa shërbimi të reduktuara, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kadastrën. Për pronat e regjistruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet shtetërore dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore nuk paguajnë tarifë regjistrimi për ndryshimet që do të rezultojnë në regjistrin e pasurive prej përditësimit, sipas këtij kreu.
  - d) Pika 5 Kreu II i projektvendimit duhet të shihet e lidhur me parimet dhe kriteret e përditësimit të parashikuara në nenin 36 të Ligjit 20/2020 sidomos lidhur me parimin e parashikuar në shkronjën "a" "përparësia e titujve të pronësisë private ndaj listës së pronave shtetërore sipas të cilit në rast se për një pronë apo pjesë prone, që figuron në listën e pronave shtetërore, ekziston titull pronësie i të tretëve, i krijuar sipas legjislacionit të posaçëm, në regjistrin publik do të regjistrohet ky i fundit". Kur institucioni administrues, Njëstië e

Vetëqeverisjes Vendore ose ASHK-ja konstaton se titulli i pronësisë private shtrihet mbi pronë publike që nuk mund të tjetërsohej i kërkon Avokaturës së Shtetit, ngritjen e padisë për njohjen e pronësisë shtetërore dhe pavlefshmërinë e titullit të pronësisë private, pranë gjykatës kompetente”.

e) Me qëllim vijueshmërinë e procesit të përditësimit, projektvendimi duhet të mos parashikojë ngarkesa më të mëdha burokratike (në terma të kërkesave dhe procesit) dhe financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Të rishikohen tarifat për pronën shtetërore si dhe elementi kohë për përsheptimin e procedurave.

**Znj. Romina KUKO**  
**Zv/Ministër i Brendshëm**  
**Bashkëkryetar**



**Z. Aldrin DALIPI**  
**Kryetar i Shoqatës së Këshillit**  
**të Qarqeve të Shqipërisë**  
**Bashkëkryetar**

